

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti për Krime të Rënda në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët : Bashkim Hyseni, kryetar, Elmaz Zenuni dhe Musa Konxheli, anëtarë, me procesmbajtësen Ardrita Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit D.S nga Prizreni, për veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 344 par.2 të KPK-së, sipas propozimit të Prokurorisë Komunale në Ferizaj, të evidentuar si: PP.nr.2171-0612, të datës 13 nëntor 2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më 30 prill 2014, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – prokurorit të shtetit - Florije Shamolli, të pandehurit, më 30 prill 2014, mori dhe komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri :

D.S, nga i ati, dhe e ëma, e gjinisë, i lindur më datë, në Prizren, jeton në rrugën “.....”Prizren, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion drejtor i “.....” me seli në Prizren, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 11 nëntor 2012, rreth orës 18:00, në rrugën magjstrale Kaçanik - Hani Elezit, ju ka premtuar për të i’u dhënë ryshfet personave zyrtar gjegjësisht policëve të Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare në Kaçanik, dha atë policëve M,K, I.A dhe G.J, që të mos kryejnë një veprim zyrtarë të cilin duhet ta kryenin, në atë mënyrë deri sa ishin në pikë kontrolli, e kishin ndalur të pandehurin te udhëkryqi i flamujve deri sa ishte duke e drejtuar veturën e markës “.....” me targa, në të cilën barte 179 (njëqind e

shtatëdhjetë e nëntë) palë këpucë pa dokumentacion, deri sa policët ishin duke e shoqëruar me veturë deri në terminalin e Hanit të Elezit, i pandehuri iu jep shenjë me drita që ta ndalnin veturën, me ç'rast del nga vetura dhe i'u ofron 3 (tre) kartëmonedha nga 50 (pesëdhjetë) €, me qëllim që policët të mos e dërgojnë mallin në doganë dhe ta lirojnë të pandehurin,

- me të cilën ka kryer veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 344 par. 2 të KPK-së.

Në bazë nenit 6, 11, 15 , 34, 35, 36, 39, 64 të KPK-së dhe nenit 365 të KPPK-së:

G J Y K O N

Dënim me Gjobë në lartësi prej 1.000 (njëmijë) €, të cilat detyrohet që ti paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata konform nenit 39 par. 3 të KPK-së, do ta zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim burgimi, duke i llogaritur për çdo 15 (pesëmbëdhjetë) € një ditë burgimi.

Konform nenit 344 par. 3 të KPK-së, konfiskohen tre kartëmonedha prej 50 €, me numër serik:,,, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i dorëzohen Agresionit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallin gjyqësor të paguaj shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë .

A r s y e t i m i

Historiku procedural, shqyrtimi gjyqësor dhe deklaratimet e palëve

Prokuroria Themelore në Ferizaj me propozim-akuzën të evidentuar si PP.nr.I-2171-06/12, të datës 13 nëntor 2012, ka akuzuar të pandehurin D.S për veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 344 par. 2 të KPK-së .

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më 30 prill 2014, në të cilën prokurori i shtetit - Florije Shamolli, ka deklaruar se mbetet pranë akuzës dhe kualifikimit juridike të veprës penale, duke propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj.

I pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që e ngarkon akuza, duke shtuar se është penduar dhe se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla.

Trupi gjykues deklarimin e të pandehurit e ka vlerësuar se i plotëson kushtet nga neni 248 par. 1 të KPPK-së pasi që i njëjti ka kuptuar:

- natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- mbështetet në faktet dhe në provat e çështjes si dëshmia e dëshmitarëve M.K, I.A dhe G.J, policë në Drejtorinë Rajonale të Policisë Kufitare në Kaçanik, kartëmonedhat e konfiskuara dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës;

Me qenë se i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 paragrafit 1 të KPPK-së, ka vazhduar seancën e shqiptimit të dënimit. (*Nëse i pandehuri në shqyrtimin gjyqësor pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi është bërë në pajtim me ligjin mundë të vazhdoj procesin me shqiptimin dënimit*).

3. Analiza e Ligjit Material

Vepra Penale Dhënia e Ryshfetit nga neni 344 par. 2 të KPK-së përcakton: *“Kushdo që jep ose premtun se do t’i jep dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, që ai person të kryej një veprim zyrtar apo veprim zyrtar apo veprim tjetër në kuadër të kompetencave të tij zyrtare, të cilin veprim ai është dashur ta kryej, ose të mos kryej në veprim zyrtar ose tjetër të cilin ai duhet ta kryej, ose kushdo që shërben si ndërmjetësues për ti dhënë ryshfet personit zyrtar”*

Trupi gjykues vlerësoi se në rastin konkret në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale, pasi që i njëjti ju ka ofruar shumën e të hollave prej 150 € oficerëve policor, me qëllim që mos të ndërmarrin veprimin zyrtar, që ish dashtë ta ndërmarrin në kuadër të kompetencave të tyre zyrtare, respektivisht ta dërgojnë në procedurat e mëtejshme ligjore për shkak të mos posedimit të dokumentacionit për mallin që ishte duke transportuar dhe dyshimet e arsyeshme për kontrabandim të këtij malli.

Përcaktimi i dënimit

Trupi gjykues me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Si rrethanë lehtësuese mori, pranimin e fajësisë, nuk ka të dhëna që më parë të ketë qenë i dënuar për vepra penale, si rrethana rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale, dhe faktin se veprimet e tilla duhet të konsiderohen të ndëshkueshme dhe të pa tolerueshme për një shoqëri ku pretendon të sundoj ligji, rrjedhimisht dënimi me gjobë i përcaktuar si në lartësinë në dispozitiv duhet të reflektoj në preventivën e përgjithshme, që ti frenojë të gjithë ata persona që potencialisht mendojnë që përmes veprimeve korruptive të realizojnë aktivitetet e tyre të paligjshme dhe të pengojnë funksionim normal dhe me integritet të lartë të institucioneve shtetërore. Nga arsyet e shpjeguara dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm dhe në harmoni me peshën konkrete

të veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale si dhe më të njëkohësisht arrihet qëllimi ndëshkimorë në kuptim të nenit 34 të KPK-së.

Konform nenit 344 par. 3 të KPK-së, konfiskohen kartëmonedhat prej 50 (pesëdhjetë) € me numër serik:,,, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i dorëzohen Agresionit për Administrimin e Pasurisë Sekuestruar ose të Konfiskuar.

Gjykata konform nenit 450 par.2 pika 6 të KPPK-së, i caktoi shpenzimet paushallë në lartësi prej 50 (pesëdhjetë) €, që është caktuar, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje penale dhe gjendjen ekonomike të të pandehurit, i cili obligohet që ti paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nga arsyet e lartpërmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PKR.nr.548/12, më 30 prill 2013

Procesmbajtësja,

Ardrita Ymeri

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,

Bashkim Hyseni

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.